

VENDIM
Nr. 73, datë 31.1.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 717, DATË 23.6.2009, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në lidhjen nr. I/8, “Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës në institucionet qendrore në varësi të ministrit të Mbrojtjes, të grupit të parë e të dytë”, në numrin rendor 1, pas emërtesës “Kontrollor cilësie, mbikëqyrës riparimi në Qendrën e Riparimit të Nivelit të Katërt të Pajisjeve Tokësore e në Bazën e Riparimit të Aviacionit”, shtohet emërtesa “Manovrator në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2020, të përballohen nga fondet e miratuara për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama